



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE
DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2361 Prot.

Pukë, më 22/12/2022

PROJEKT-VENDIM

Nr. 14 Datë 22/12/2022

PËR

“MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT SOCIAL 2022-2027”

Këshilli Bashkiak Pukë në mbledhjen e tij të radhës. Mbeshtetur në ligjin Nr.139/2015 2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" neni 24 dhe 54 shkronja "k", si edhe në nenin 68 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social", me propozim të Kryetarit të Bashkisë, Këshilli Bashkiak,

VENDOSI:

1. Te miratoje "Programin 5-vjeçar të strehimit social 2022-2027".
2. Per ndjekjen e zbatimin e ketij vendimi ngarkohet Sektori i Ndhmës Ekonomike dhe Shërbimit Social, Drejtoria e Financës dhe Buxhetit, sipas përkatësisë të gjitha drejtoritë dhe sektoret .
3. Ky vendim hyn në fuqi sipas nenit **24,54** shkronja "k" , e ligjit nr.139/2015 "Për VetëqeverisjenVendore".
4. U shpall me date ___/___/_____.

Hartues

Anjeza Doda

Melita Furriku

Juriste

Aida Sinani

KRYETARI

Gjon Gjonaj





REPUBLIKA E SHQIPËRISË
BASHKIA PUKË
SEKTORI I NDIHMËS EKONOMIKE
DHE SHËRBIMIT SOCIAL

Nr. 2361/Prot.

Pukë, më 23/12/2022

RELACION

PËR

MIRATIMIN E PROGRAMIT 5-VJEÇAR TË STREHIMIT SOCIAL 2022-2027

DREJTUAR : KËSHILLIT BASHKIAK PUKË

Mbeshtetur në ligjin 139/2015 "Për Vetëqeverisjen vendore" neni 24 dhe 54 shkronja "k", si edhe në nenin 68 të ligjit 22/2018 "Për strehimin social". Ligji citon se: Strukturat përkatëse të njësisë së vetëqeverisjes vendore hartojnë programe 5-vjeçare strehimi social për popullsinë nën juridiksionin e tyre, duke u mbështetur në analizën e nevojave për strehim dhe në përputhje me strategjinë e strehimit social, sipas parashikimeve të këtij ligji, Sektori i Ndihmës Ekonomike dhe Shërbimit Social Bashkia Pukë me asistencën e IP3 dhe D&C Partners me mbështetjen e UNDP, në kuadër të programit të Përbashkët të Kombeve të Bashkuara "Askush të mos mbetet pas/ Leave no one behind", i cili financohet nga Agjencia Zvicerane për Zhvillim dhe Bashkëpunim (SDC). U hartua Programi 5-vjeçar i Strehimit Social 2022-2027.

Ky dokument trajton çështjet e programit 5-vjeçar sipas ligjit dhe propozon zgjidhje alternative në lidhje me strehimin social në Bashkinë Pukë, në përputhje me kapacitetet teknike dhe financiare të bashkisë si dhe situatën aktuale të familjeve potencial për strehim. Dokumenti përmban një vizion dhe objektiva të zërthyera në programin konkret me aktivitete.

Ky Plan mbështetet në nevojat për strehim të familjeve me të ardhura të ulëta dhe, sidomos, të grupeve në pozita të pafavorizuara (siç përcaktohet në ligj) përbëjnë prioritet.

Plani 5-vjeçar i Strehimit Social përmban:

- 1- vlerësimin e kontekstit aktual dhe nevojave për strehim social për grupet e përcaktuara në ligj dhe veçanërisht ato më vulnerabël brenda territorit të bashkisë;
- 2- vlerësimin e kapaciteteve humane, teknike, financiare dhe organizative në bashki për të adresuar shërbime/nevoja të tilla;
- 3- propozime konkrete dhe vlerësime të buxhetit për zbatimin e tyre, sipas nevojave për strehim dhe instrumenteve ligjore e financiare.

Gjithashtu, ky plan bazohet në parime të tjera të përcaktuara në ligjin për strehimin social si:

- Parimi i strehimit të përballueshëm;
- Parimi i strehimit të përshtatshëm;
- Parimi i transparencës dhe informimit;
- Parimi i sigurisë së qëndrimit.

Grupi i punës ka realizuar një vlerësim të thelluar të situatës ekzistuese në bashkia, e cila përmban:

- Analizë e kontekstit lokal si trendet demografike dhe socio-ekonomike të popullsisë;
- Analizë e kapacitetit financiar dhe teknik të bashkisë;
- Analizë e grupeve vulnerabël dhe të marginalizuara me qëllim identifikimin e kategorive që kanë nevojë për strehim dhe analizë të nevojave të tyre për strehim;
- Analizë e nevojave sociale dhe të përballueshme për strehim;
- Analizë e tokës potenciale që mund të përdoret për qëllime banimi social;
- Analizë e programeve të mundshme të strehimit që mund të aplikohen në bashkia;

Nëpërmjet këtij plani, Bashkia Pukë synon të përmirësojë sektorin e strehimit, vecanërisht për grupet më në nevojë, duke diversifikuar gamën e programeve të aplikuara, si dhe duke praktikuar instrumente financiare të reja.

Analiza , objektiva ,qëllimet ,programet e detajuara i gjeni në dokumentin bashkangjitur.

Sa më lart, i propozojmë Këshillit Bashkiak Miratimin e Programit 5-vjeçar të strehimit social 2022-2027.

Duke shpresuar për miratimin e këtij materiali nga ana juaj.

Hartues

Anjeza Doda

Melita Furriku

KRYETARI

Gjon Gjonaj

